



Prishtinë, 20.11.2024

Ref. 001/KPMM

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 63 paragrafit 1 të Ligjit nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 39 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale; si dhe duke marr parasysh dispozitat e nenit 49 paragrafit 1 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në mbledhjen e mbajtur me dt. 20.11.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Xhavit Raci përzgjidhet për pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.
2. Emërimi në pozitën Drejtor i Përgjithshëm në KPMM bëhet për një kohëzgjatje katër (4) vjeçare, sipas paragrafit 5 të nenit 49 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.
3. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të KPMM-së.

A R S Y E T I M

Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në pajtim me kompetencat e përcaktuara në nenin 63 paragrafit 1 të Ligjit nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 39 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale si dhe dispozitat e nenit 49 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me dt. 16.07.2024 ka shpallur pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm i KPMM-së - Drejtues i Lartë me Nr. Ref. RN00014538.

Në pajtim me Ligjin nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit nr. 2234 të datës 01.10.2024 ka publikuar njoftim lidhur me kandidatët e suksesshëm dhe rrjedhimisht me datë 21.10.2024 ka dorëzuar listën e kandidatëve fitues të pozitës Drejtor i Përgjithshëm në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Sipas Komisioni i Pranimit, kandidatët fitues të pozitës Drejtor i Përgjithshëm në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale janë:

1. *Xhavit Raci – 80 pikë: dhe*
2. *Haradin Gërvalla – 79.2 pikë.*

Në mbledhjen e (XIII) Bordit të KPMM-së të mbajtur me datë 20.11.2024, Kryesuesi i Bordit ka njoftuar anëtarët e Bordit lidhur me ecurinë e procesit dhe rrjedhimisht listën e kandidatëve të propozuar nga Komisioni i Pranimit ku sipas raportit të dorëzuar konstatohet se të dy

Rr. Armend Daci Nr.1 Prishtinë, Kosovë Tel: +383 (38) 240 252 Fax: +383 (38) 245 844 E-mail: ICMM@kosovo-mining.org	<p>DALJE</p> <p>NR. PROT. 001 BR. PROT. 3240 NR. PROT. 3240</p> <p>DD MM VVVV 20.11.2024</p>	Kuvendi i Kosovës Skupština Kosova Assembly of Kosovo
---	--	---

kandidatët e lartcekur kanë kaluar pragun prej 70% dhe të dy kandidatët konsiderohen kandidatë të suksesshëm.

Pas diskutimeve dhe vlerësimit të Bordit të KPMM-së se procesi ishte i rregullt nga të gjithë anëtarët e Bordit, Bordi në mbështetje të nenit 63 paragrafit 1 të Ligjit nr.03/L-163 për Minierat dhe Minerale të plotësuar dhe ndryshuar me nenin 39 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-158 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale; si dhe nenit 49 paragrafit 1 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, vendosi që kandidati z. Xhavit Raci të përzgjidhet për pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm i KPMM-së.

Dr. Habib Basholli



Kryesues i Bordit

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale



Vendimi i dërgohet:

- Bordit të KPMM-së;
- Njësisë së Burimeve Njerëzore;
- Arkivit të KPMM-së.